



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHIJAK
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 4273/Prot
12

Shijak, më 09.09.2025

VENDIM NR. 35 DATË 08.09.2025

**PËR MIRATIMIN E PLANIT VENDOR TË VEPRIMIT PËR BARAZINË GJINORE TË
BASHKISË SHIJAK 2026–2028**

Këshilli Bashkiak Shijak, mbështetur në: Nenin 54 dhe 55 të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, Ligjin nr. 9970, datë 24.07.2008, “Për barazinë gjinore në shoqëri”, Ligjin nr. 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”. Ligjin nr. 10221, datë 4.2.2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar, Strategjinë Kombëtare për Barazi Gjinore 2021–2030, miratuar me VKM nr. 334, datë 30.6.2021, Udhëzimin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për integrimin e çështjeve gjinore në dokumentet e zhvillimit vendor dhe buxhetore, Udhëzimin nr. 348, datë 11.06.2020, “Për ngritjen e mekanizmave të koordinimit për barazinë gjinore në nivel vendor”, Programin për Reformën në Administratën Publike 2022–2030, Udhëzuesin e miratuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për hartimin e Planeve të Veprimit Vendor për Barazinë Gjinore;

Duke marrë parasysh propozimin e Kryetarit të Bashkisë Shijak dhe pas shqyrtimit të Planit Vendor për Barazinë Gjinore 2026–2028, që ka si qëllim forcimin e mekanizmave vendorë për barazinë gjinore, përmirësimin e aksesit të grave dhe vajzave në vendimmarrje, si dhe fuqizimin e tyre ekonomik e social, mbrojtjen e të drejtave të grave dhe vajzave dhe ofrimin e shërbimeve të barabarta,

VENDOSI:

1. Miratimin e Planit të Veprimit për Barazinë Gjinore të Bashkisë Shijak për periudhën 2026–2028, si një instrument strategjik për sigurimin e një përqaasje efektive të barazisë gjinore në të gjitha fushat e jetës shoqërore dhe administrative vendore, duke adresuar nevojat, mundësitë dhe sfidat e identifikuara në territorin e saj.

2. Ngarkohet Sektori i Ndhmës Ekonomike dhe Shërbimeve Sociale , në bashkëpunim me Specialistët për Barazinë Gjinore, të ndjekë zbatimin e këtij Plani dhe të raportojë periodikisht mbi progresin në Këshillin Bashkiak.

3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

KRYETARI

Sulejman Tola

